



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

POLITIKAT E PRIVATËSISË

SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave tuaja personale është prioritet kryesor i Doganes së Kosovës, e cila angazhohet të përpunojë të dhënat tuaja personale me përgjegjësi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodin Doganor dhe të Akcizave nr. 08/L-247 dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale

Kjo politikë e aplikuar në ruajtjen e privatësisë nga të punësuarit aktual dhe ish-punonjësit e Doganes së Kosovës, ju ofron informacionet e nevojshme se cilat janë pritjet në mbledhjen e të dhënave tuaja personale, njëkohësisht dhe ruajtjen e tyre sa i perket informacioneve lidhur me:

- individët të cilët paraqesin kërkesë për marrje informacioni apo dokumentacioni;
- dhënie konsulence;
- nëse, merrni pjese në trajnim të organizuar nga Dogana;
- paraqisni kërkesë përmes email-it apo vizitoni ueb faqen e Doganes;
- nëse jeni aplikant për punë, apo palë kontraktuese.

PERSONI PERGJEGJES

Personi kontaktues në Doganën e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e emëruar me vendimin Drejtorit të Përgjithshëm nt. prot: 01/1148/2023 dt. 13.10.2023 është: Oficerja Doganore Gyltene Sylja, Dogana e Kosovës E-mail adresa: gyltene.sylja@dogana-ks.org.

PERSONAT TË CILËT PËRDORIN SHËRBIMET E DOGANËS SË KOSOVËS

Dogana e Kosovës ofron shërbime të ndryshme për publikun. Detajet e të dhënave të ofruara mbahen me qëllim të ofrimit të shërbimeve ndaj subjektit, kur nga ky i fundit kërkohen dhe për qëllime të tjera lidhur ngusht me kërkesat e kërkuesit.

Dogana e Kosovës çdoher kur mbledhë të dhëna personale, informon subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni.

VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT

Dogana e Kosovës disponon faqen zyrtare të institucionit me këtë adresë elektronike: <https://dogana.rks-gov.net/> përmes së ciles transmeton dhe mbledh informacione.

Për vizitorët e <https://dogana.rks-gov.net/> sistemi mbledh informacione standarde të cilat kanë të bëjnë me klikimet të rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mbledhet për qëllime statistikore dhe studimi mbi përdorimin e faqes dhe shërbimeve të saj, gjithnjë pa i bërë të identifikueshëm vizitorët.

- Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit;
- Të dhënat e kontaktit: adresa, e-mail, numri i telefonit;
- Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale;

Dogana e Kosovës nuk ndërmerr asnjë veprim për identifikimin e vizitorëve të faqes sonë të internetit e poashtu nuk lejon as palët e treta që përmes përdorimit të mjeteve të tilla statistikore apo analitike të mbledhë informacione personale të cilat i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e faqes tonë zyrtare. Dogana e Kosovës shmang çdo lloj lidhjeje të të dhënave të grumbulluar nga kjo faqe si pjesë e përdorimit tonë me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm. Nëse përmes faqes sonë do donim të mbledhnim informacione të identifikueshme personalisht, do ju informonim paraprakisht.

APLIKANTËT PËR PUNË, TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH-PUNONJËSIT E DOGANËS SË KOSOVËS

Për rastet e punësimit nëpërmjet konkursit (sipas legjislacionit në fuqi) kandidatët depozitojnë në institucion tonë dosjen personale me të dhënat përkatëse. Pas përfundimit të procedurës këto të dhëna administrohen nga institucioni dhe ju vihen në dispozicion subjekteve të cilët kanë të drejtë kontrolli (në rastet kur kërkohet).

Për punonjësit aktual të Doganes së Kosovës, Sektori i Burimeve Njerëzore krijon dhe administron dosjen e personelit për çdo të punësuar ku të dhënat e përfshira në të mbahen të sigurta dhe përdoren vetëm për qëllime me rëndësi të drejtpërdrejtë mbi punësimin e personit. Kur punësimi i punonjësve pranë Doganes së Kosovës

përfundon, Ne mbajmë dosjen në përputhje me legjislacionin në fuqi, ligjin për arkivat dhe aktet e brendshme normative.

BAZA LIGJORE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE

Dogana Kosves përpunon të dhëna personale te subjekteve bazuar ne dispozita te Kodit Dognaor dhe te Akciazve Ligji nr. 08/L-247 dhe ne perputhje me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e te dhenave Personale dhe në pajtim me legjislacionin evropina per mbrojtjne e te dhenave personale. Ne disa raste Dogna e Kosovës përpunon të dhenat personale vetem pas pelqimit paraprak te subjekteve të të dhenave, i cili ka te drejte dhe mund te tërhiqet ne çdo kohe.

QASJA NË TË DHËNAT PERSONALE

Dogana e Kosovës është e hapur dhe u ofron individëve qasje në të dhënat e tyre personale përmes deponimit të një kërkesë për qasje në të dhënat personale, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-082 për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

ME KË NDAHEN TË DHËNAT PERSONALE TË MBLEDHURA

Ndarja e të dhënave personale të mbledhura, kryesisht bëhet me autoritetet kompetente të sigurisë, gjyqësore dhe mbikqyrëse, të cilat përmes një akti juridik kanë autoritetin të kërkojnë nga Dogna e Kosovës të dhënat personale për subjekte të caktuara.

KUR NE DISPONOJMË ME TË DHËNAT E TUAJA PERONALE

Ne mund të ju ofrojmë: - një përshkrim të të dhënave; - informacion se përse i mbajmë të dhënat; - informacion se tek cili marrës mund t'i përhapim këto të dhëna; - ofrojm një kopje të informacionit në një formë të kuptueshme; Për çdo të dhënë personale që Dogana e Kosovës mund të mbajë është e nevojshme të bëni një kërkesë me shkrim përmes zyres administrative e të drejtuar Zyrtarit përgjegjes për Mbrojtje e të Dhënave personale. Kërkesa në parim qdo herë shqyrtohet në në afatin e paraprë ligjor por nëse DK e konsideron të arsyeshme dhe paraprakisht është e pranueshme dhe e dakorduar me palën trajtimi mund të bëhet duke iu dhënë informacionin specifik nëpërmjet telefonit. Në rast se të dhënat e mbajtura përmbajnë gabime, ju mund të kërkonit korrigjimin e gabimeve në të dhënat e ofruara, duke kontaktuar edhe një here Zyrtarin përgjegjes për Mbrojtje e të Dhenave personale. Ne, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës suaj do t'ju informojmë për kryerjen apo moskryerjen e korrigjimit.

CILAT JANË TË DREJTAT TUAJA

Kur të dhët tuaja personale përpunohen nga Dogana, ju keni te drejtë: të qasjes ne qdo kohë, të korigjimit apo perditesimit të tyre, te fshirjes, përpunimit te tyre, në rrethana të caktuara komunikimi i te dhenave të ndryshuara paleve nese më parë u jane zbuluar, si dhe të drejten e ankeses, te gjitha keto në perputhje me Ligjin nr. 06/L-082 për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

LIDHJET ME FAQET E TJERA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera.

E DREJTA E ANKIMIMIT

Çdo person fiziki i cili beson se i janë shkelur të drejtat, për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të parashtrojë ankesë tek Agjencioni për Informim dhe Privatësi të Republikës së Kosovës dhe ne Doganën e Kosovës.

POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Dogana e Kosovës, duke zbatuar masat e duhura për të mbrojtur të dhënat tuaja personale, përpunon informacionin dhe është e angazhuar për të siguruar përdorimin e informacionit dhe informacionin e sistemeve të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit nën kontrollin e saj, konform Ligjit nr. 06/L-082.

Dogana e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së informacionit nga përdorimi i paautorizuar, ndryshimi, zbulimi apo shkatërrimi aksidental apo i qëllimshëm përdor një qasje të bazuar në risk, gjatë vlerësimit dhe të kuptuarit të rreziqeve si dhe përdor të gjitha mjetet fizike organizative dhe teknike për të arritur masat e duhura të sigurisë.

DOGANA E KOSOVES